

TESTI PROFESIONAL

ÇELËSI I ZGJIDHJES

KAZUS CIVIL 5

1. Pyetja e parë:

Përcaktoni natyrën e marrëdhënies juridike të lindur sipas kësaj kontrate, mes paditësit shoqërisë "OMT" dhe të paditurit Radio Televizionit Shqiptar. (10 pikë)

Natyra e marrëdhënies juridike të lindur sipas kësaj kontrate, mes paditësit shoqërisë "OMT" dhe të paditurit Radio Televizionit Shqiptar është e përzier administrative/civile.

Kontrata e lidhur nga një subjekt i të drejtës administrative (Radio Televizioni Shqiptar), në kushtet që, Radio Tv Shqiptar vepron në ushtrim të funksionit publik, kontratën është i detyruar t'a lidhë në bazë të procedurave të prokurimit publik konsiderohet "kontratë administrative".

Vendimi Njësues Nr. 302, datë 26.05.2023 dhe 22.09.2023, shprehet se:

- *Së pari: Një kontratë do të konsiderohet administrative, kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) verifikohet domosdoshmërisht edhe krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike konkrete, për shkak të zbatimit të normave të së drejtës publike (kriteri material), në funksion të një shërbimi publik dhe të realizimit të një interesi publik, të cilit i shërben. Për rrjedhojë, është edhe natyra juridike (shkaku ligjor i mosmarrëveshjes në gjykim), që do të përcaktojë gjykatën kompetente.*
- *Së dyti: Elemente kryesore përcaktues për identifikimin e një kontrate administrative janë: shërbimi në interesin publik, që përbën shkakun e kontratës; kufizimi i lirisë kontraktore; epërsia e organit publik, në kuptim të kufizimit të vullnetit kontraktor të palës tjetër për kushte të caktuara të panegociueshme të kontratës, të rregulluara nga e drejta publike; karakteri specifik i kontratës, lidhur me të drejtën e organit publik për tërheqje të njëanshme nga kontrata, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.*
- *Së treti: Në një kontratë administrative palët qëndrojnë në raport me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të fuqisë/pushtetit sovran, ku mbajtësi i këtij sovraniteti bazohet te kuadri normativ i së drejtës publike. Kontrata është administrative, kur pavarësisht pjesëve të saj që normohen nga e drejta private, evidentohet qartë se rregullimi në tërësi i saj nga normat e së drejtës publike peshon më shumë.*
- *Së katërti: Dallimi mes kontratës publike dhe private, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, bëhet jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së saj dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Objekti, qëllimi*

dhe normat, që rregullojnë marrëdhënien juridike, duhet të evidentohen qartë si nga palët në proces, ashtu edhe në analizën dhe konkluzionin, që nxjerr gjykata lidhur me këtë çështje.

Nga ana tjetër, të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë kontratë nuk i shmangen rregullimeve të së drejtës private pasi pasojat e mospërbushjes së detyrimeve kontraktore rregullohen nga e drejta private (Kodi Civil).

2. Pyetja e dytë:

Analizoni përgjegjësinë civile nga mospërbushja në kohë e detyrimit të marrë përsipër në bazë të kësaj kontrate nga shoqëria "OMT". (10 pikë)

Sipas nenit 481 të Kodit Civil “ Debitori që nuk përmbush një detyrim të kërkueshëm në afatin e caktuar, quhet se është në vonesë (morë), përveç kur mosekzekutimi është rrjedhim i rrethanave që nuk kanë lidhje me fajin e debitorit. Debitori vihet në vonesë me anë të një njoftimi me shkrim”.

Vonesa mund të ketë pasojë “shpërblimin e dëmit nga përmbushja me vonesë e detyrimit ” (neni 484 Kodit Civil), ose zgjidhjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmit (neni 698 Kodit Civil).

Në rrethanat e përshkruara në kasus, afati për përmbushjen e detyrimit të dorëzimit të sendit nga debitori (shoqëria “OMT) ka përfunduar më datë 28.12.2021.

Debitori ka pretenduar se ky afat ka kaluar për shkak të rrethanave që nuk vareshin prej tij por për shkak të “forcës madhore”.

Në kontratë palët kanë parashikuar se, nëse nuk realizohej dorëzimi në afatin e caktuar në kontratë, Radio TV Shqipatr “*ka të drejtën për t’a deklaruar kontratën të zgjidhur menjëherë*”.

Sipas nenit 702 të Kodit Civil, “Palët mund të parashikojnë në kontratë që ajo të zgjidhet kur një detyrim i caktuar nuk përmbushet sipas kushteve të parashikuara. Në këtë rast kontrata zgjidhet kur pala e interesuar i deklaron palës tjetër se do të përdorë kushtin e zgjidhjes së kontratës”.

Nga rrethanat e faktit të përshkruara në kasus, rezulton se, në përgjigje të kërkesës së shoqërisë për të zgatur afatin edorëzimit, Radio Tv ka deklaruar se, “ kërkesa për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të kontratës nuk mund të merrej parasysh” për shkak të rregullave që lidhen me pagesat nëpërmjet buxhetit të shtetit.

Gjithashtu, nga rrethanat e faktit deklarohet se në momentin në të cilin shoqëria “ OMT” ka kërkuar të kryejë dorëzimin me shkresën e datës 19.01.2022, Radio Tv nuk ka pranuar të marrë dorëzimin.

3. Pyetja e tretë:

Analizoni rrethanat që kanë çuar në mospërbushjen në afat të detyrimit nga shoqëria "OMT". (10 pikë)

Në rrethanat e përshkruara në kazus, afati për përmbushjen e detyrimit të dorëzimit të sendit nga debitori (shoqëria "OMT) ka përfunduar më datë 28.12.2021.

Me shkresën e datës 19.01.2022 shoqëria "OMT" shpk ka deklaruar gatishmërinë për të bërë dorëzimin e porosisë, por Radio Tv Shqiptar nuk ka pranuar duke deklaruar se ka përfunduar afati i dorëzimit.

Ndërkohë, nëpërmjet shkresës datë 23.12.2021, shoqëria "OMT" shpk kishte kërkuar shtyrjen e afatit të kontratës deri më datë 20.01.2022, duke arsyetuar se, në respektim të nenit 26 të kontratës po ju njoftojmë menjëherë për konstatimin e situatës së forcës madhore, pasi si pasojë e vendosjes së menjëhershme dhe të paparashikuar të masave strikte Anti Covid sipas njoftimit zyrtar të datës 18.12.2021 nga shteti Holandez, është anuluar shkarkimi i kontenerëve të parashikuar për Rotterdam Euromax Terminal.

Në kazus nuk vihet në dyshim vërtetësia e këtij pretendimi.

Për rrjedhojë, shkak i mospërbushjes në afat të detyrimit nga shoqëria " OMT" ka qenë "anulimi i shkarkimit të anijeve në portin detar të Rotterdamit".

4. Pyetja e katërt:

Cilat janë elementet përbërës të Forcës Madhore? Arsyetoni nëse jemi para forcës madhore në këtë rast dhe jepni zgjidhjen e çështjes në varësi të arsyetimit tuaj lidhur me përgjegjësinë civile për mospërbushjen e detyrimit në kohë. (10 pikë)

Ndonëse vetë legjislacioni nuk ka përcaktuar **definim** shterues për forcën madhore, doktrina apo jurisprudenca kanë përcaktuar elementët thelbësorë të saj që janë "paparashikueshmëria dhe paevitueshmëria e një ngjarje penguese për përmbushjen e detyrimeve nga debitori". Në thelb një debitor nuk konsiderohet se është në faj për mospërbushjen e detyrimeve kontraktore nëse provohet ekzistenca e ngjarjeve që e bëjnë të pamundur përmbushjen e detyrimeve nga ana e tij.

Në rastin konkret, këtë rrethanë që shkarkon debitorin nga detyrimi palët e kësaj kontrate e kanë parashikuar në nenin 26 të kontratës sipas së cilës " *Për qëllimet e këtij neni "Forcë madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme nga ana e tij. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga veprimet e autoritetit kontraktor qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti*".

Duke iu referuar rrethanave të kazusit rezulton se, ndonëse afati i dorëzimit është konsideruar thelbësor për kontratën, mospërbushja e detyrimit për dorëzimin në afat ka ndodhur për shkaqe

të pavarura nga debitori por, për shkak të “forcës madhore” sipas përcaktimit që vetë palët kanë parashikuar në nenin 26 të kontratës.

Për rrjedhojë, shoqëria “OMT” shpk nuk konsiderohet në vonesë në momentin që ka shprehur vullnetin për të kryer dorëzimin dhe Radio Tv Shqiptar , me cilësnë e kreditorit duhej të kishte pranuar marjen në dorëzim të pajisjeve të kontraktuara dhe pagimin e çmimit sipas kontratës.

5. Pyetja e pestë:

Nëse ju do të ishit gjyqtari/gjyqtarja i/e kësaj çështje. cila do të ishte mënyra e zgjidhjes së kesaj çështje? Formuloni dispozitivin e vendimit. (10 pikë)

-Do të vlerësohet lidhur me rrjedhën llogjike të analizës dhe argumentave në pyetjet e mësipërme me konkluzionin në dispozitiv.

-Elementët përbërës të dispozitivit (shpenzimet gjyqësore, e drejta e ankimit)

KRIRET E VLERËSIMIT:

- a. Struktura / rrjedhshmëria (S)
- b. Argumentimi (A)
- c. Konkluzioni (K)

Vangel Kostaj

TESTI PROFESIONAL

ÇELËSI KAZUS PENAL Nr.9

Pyetja 1 (10 pikë)

Kualifikoni juridikisht veprimet e shtetasit R.T.

Nga të dhënat e kazusit rezulton se shtetasi R.T. ka mbajtur në banesën e tij një sasi lënde narkotike me qëllim shitjeje, si dhe një armë zjarri pa leje .

Së pari, mbajtja e lëndës narkotike me qëllim shitjeje përbën veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në këtë kuadër, nga të dhënat e kazusit rezulton se:

- R.T. ka deklaruar se një pjesë e lëndës narkotike i është dhënë nga L.P.
- ekzistojnë komunikime telefonike midis tyre që kanë çuar në identifikimin e L.P.
- në banesën e L.P. janë gjetur sasi të tjera lënde narkotike dhe mjete për përpunimin e saj

Këto elemente tregojnë se nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie rastësore, por me një veprimtari të koordinuar, që përfshin furnizim dhe mbajtje të lëndës narkotike. Në këtë kuptim, plotësohen elementet e bashkëpunimit penal, të reflektuara edhe në paragrafin e dytë të nenit 283 të Kodit Penal, i cili parashikon kryerjen e kësaj vepre në bashkëpunim. Nga rrethanat del ekzistenca e një marrëveshjeje bashkëpunimi, një qëllimi të përbashkët për shpërndarjen e lëndës narkotike.

Së dyti, mbajtja e armës së zjarrit pa leje përbën veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, në banesë sipas nenit 278 paragrafi 4 të Kodit Penal.

Në përfundim, veprimet e shtetasit R.T. kualifikohen juridikisht si:

- Prodhim dhe shitje e narkotikëve (neni 283, paragrafi 2 i Kodit Penal), në bashkëpunim
- Mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake në banesë (neni 278, paragrafi 4 i Kodit Penal)

Pyetja 2 (10 pikë)

Analizoni përgjegjësinë penale të shtetasit L.P

Nga të dhënat e kazusit rezulton se shtetasi L.P. është identifikuar si person i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme lidhur me lëndët narkotike, bazuar në deklaratimet e R.T., komunikimet ndërmjet tyre dhe provat e gjetura në banesën e tij.

Për sa i përket pjesës së lëndës narkotike që është gjetur në banesën e R.T. dhe që, sipas provave, i është dhënë nga L.P., duhet bërë referencë te analiza e kryer në pyetjen e parë. Në këtë pjesë provohet ekzistenca e një veprimtarie të përbashkët dhe, për rrjedhojë, përgjegjësia penale e L.P. qëndron në kuadër të bashkëpunimit penal, sipas nenit 283, paragrafi 2 i Kodit Penal, në bashkëpunim me shtetasin R.T.



Ndërsa për sa i përket lëndës narkotike dhe mjeteve për përpunimin e saj të gjetura në banesën e L.P., nuk rezulton të provohet se shtetasi R.T. ka pasur dijeni apo përfshirje në këtë pjesë të veprimtarisë. Në mungesë të provave për një marrëveshje apo koordinim edhe për këtë pjesë, nuk mund të konkludohet ekzistenca e bashkëpunimit penal.

Për rrjedhojë, për lëndën narkotike të gjetur në banesën e shtetasit L.P., si një fakt penal më vete, ai mban përgjegjësi penale individuale për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, sipas nenit 283, paragrafi 1 i Kodit Penal, në formën e mbajtjes së lëndës narkotike me qëllim shpërndarjeje.

Në përfundim, përgjegjësia penale e shtetasit L.P. paraqitet në dy plane:

- Neni 283, paragrafi 2 i Kodit Penal në bashkëpunim me R.T., për pjesën e lëndës narkotike të furnizuar dhe të gjetur në banesën e këtij të fundit
- Neni 283, paragrafi 1 i Kodit Penal në mënyrë individuale, për lëndën narkotike dhe mjetet e gjetura në banesën e tij

Pyetja 3 (10 pikë)

Vlerësoni nëse nga faktet rezulton ekzistenca e një forme bashkëpunimi ndërmjet R.T. dhe L.P. dhe çfarë forme konkrete mund të marrë ajo.

Nga faktet e kazusit rezulton se bashkëpunimi ndërmjet shtetasve R.T. dhe L.P. ekziston vetëm për sa i përket sasisë së lëndës narkotike të gjetur në banesën e R.T. Nga deklaratimet e këtij të fundit, komunikimet telefonike dhe provat e gjetura në banesën e L.P., provohet se nuk kemi të bëjmë me një marrëdhënie rastësore, por me një veprimtari të koordinuar, e cila përbën bashkëpunim të thjeshtë në formën e bashkëautorësisë .

Në kuptimin penal, bashkëautorësia kërkon ekzistencën e një marrëveshjeje, një qëllimi të përbashkët dhe kontribute konkrete në realizimin e veprës penale. Në rastin konkret, këto elemente rezultojnë të plotësuara për segmentin e përbashkët të veprimtarisë.

Konkretisht, veprimet aktive të të dy subjekteve konsistojnë në sigurimin e lëndës narkotike nga ana e L.P, mbajtjen e saj nga ana e R.T. me qëllimin e përbashkët për shpërndarjen e saj

Këto veprime tregojnë një kontribut të ndërsjellë dhe të koordinuar, në funksion të realizimit të së njëjtës vepër penale, duke përjashtuar një përfshirje të rastësishme apo të shkëputur.

Pyetja 4 (10 pikë)

Cili është objekti i shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe në çfarë kufijsh ajo mund të rivlerësojë provat e administruara në shkallë të parë?

Objekti i shqyrtimit në gjykatën e apelit përcaktohet nga ankimet e paraqitura nga palët, si dhe nga shkaqet e ngritura në to, në përputhje me nenin 425 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se gjykata e apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit.

Në këtë kuptim, objekti i shqyrtimit përfshin:

- pretendimet mbi vlerësimin e provave
- ligjshmërinë e provave të administruara
- zbatimin e ligjit material dhe procedural

Në rastin konkret, të dy të pandehurit kanë kundërshtuar vlerësimin dhe ligjshmërinë e provave, çka e bën këtë aspekt pjesë të drejtpërdrejtë të shqyrtimit në apel .

Sa i përket kufijve të rivlerësimit të provave, gjykata e apelit ka kompetencë të:

- rivlerësojë provat e administruara në shkallë të parë
- kontrollojë ligjshmërinë e tyre
- verifikojë nëse përfundimet e gjykatës janë të bazuara në prova

Pyetja 5 (10 pikë)

Në kushtet konkrete të rastit, a duhet të pranojë gjykata e apelit kërkesën për administrimin e ekspertimit teknik mbi telefonin celular si provë të re? Argumentoni.

Sipas nenit 427, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale Pranimi gjykata e apelit vendos sipas rastit pranimin e provave të reja vetëm kur këto prova janë zbuluar pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë, ose dalin aty për aty gjatë shqyrtimit në apel. Pra, ligjvënësi ka vendosur një kufi të qartë: provat e reja nuk mund të paraqiten lirisht në apel, por vetëm nëse plotësojnë këto kushte.

Në rastin konkret, mbrojtja e shtetasit L.P. ka kërkuar administrimin e një prove të re, konkretisht një akt ekspertimi teknik mbi telefonin celular, duke pretenduar se kjo provë nuk është kërkuar më parë për shkak të mungesës së aksesit të plotë në të dhënat teknike gjatë gjykimit në shkallë të parë .

Ky pretendim nuk qëndron, pasi:

- gjatë gjykimit në shkallë të parë, fashikulli i sjellë për gjykim vihet në dispozicion të plotë të palëve
- mbrojtja ka pasur mundësi të kërkojë një akt ekspertimi teknik mbi telefonin celular të sekuestruar gjatë gjykimit në shkallë të parë
- prova nuk rezulton të jetë zbuluar pas gjykimit në shkallë të parë dhe as të ketë dalë gjatë shqyrtimit në apel


Për rrjedhojë, nuk plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 427/2 K.Pr.P. për pranimin e provave të reja.

Në përfundim, në kushtet konkrete të rastit, gjykata e apelit nuk duhet ta pranojë kërkesën për administrimin e ekspertimit teknik si provë të re, pasi nuk plotësohen kriteret ligjore të nenit 427, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale.

Klodian Kureshi



Jolles Peci



TESTI PROFESIONAL

ÇELËSI I PËRGJIGJEVE TË KAZUSIT ADMINISTRATIV NR. 6

me pikëzim orientues dhe përgjigje të balancuara sipas peshës së secilës pyetje

Shënim metodologjik:

Pikët e mëposhtme janë orientuese për vlerësimin e përgjigjeve. Kandidati merr pikët maksimale kur identifikon saktë natyrën juridike të akteve, kompetencën funksionale, legjitimitimin aktiv dhe instrumentin e gjykimit incidental, duke i zbatuar këto koncepte mbi faktet konkrete të kazusit. Përgjigjet janë riformuluar në mënyrë proporcionale me peshën e pyetjeve; trajtimi më i zgjeruar i takon pyetjes nr. 3, e cila ka 15 pikë.

Pyetje nr. 1 = 8 pikë

Përcaktoni natyrën juridike të dy akteve të kundërshtuara. Jepni argumentet tuaja nëse janë akte administrative individuale apo akte nënligjore normative.

Pikëzimi orientues:

Elementi i vlerësimit	Pikët
Identifikimi i vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë si akt nënligjor normativ.	2 pikë
Argumentimi me kriteret: subjektet, objekti dhe karakteri shterues/jo shterues i aktit.	3 pikë
Identifikimi i Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore si akt administrativ individual.	2 pikë
Zbatimi i dallimit mbi faktet konkrete të kazusit dhe përdorimi i saktë i terminologjisë juridike.	1 pikë

Përgjigje:

Vendimi datë 26.12.2018 i Këshillit Bashkiak Krujë është akt nënligjor normativ. Ai shpreh vullnetin e organit të vetëqeverisjes vendore në ushtrim të funksionit publik, duke vendosur rregulla të përgjithshme për nivelin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë për vitin 2019. Ky akt nuk i drejtohet vetëm shoqërisë "A" sh.a., por një kategorie të përgjithshme subjektësh që ushtrojnë veprimtari në territorin e Bashkisë Krujë dhe që mund të bien në fushën e zbatimit të tarifës për rrjetin kabllor telefonik, ndërlidhës apo të shërbimit informatik.

Kategorizimi si akt nënligjor normativ përputhet me nenin 2, pika 3, të ligjit nr. 49/2012 dhe me kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për dallimin ndërmjet aktit normativ dhe aktit individual: subjektet të cilave u drejtohet akti, objekti i tij dhe karakteri shterues ose jo shterues. Në rastin konkret, VKB-ja përcakton norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, për një numër të pacaktuar situatash dhe subjektësh, dhe nuk shteron me një zbatim të vetëm. Për këtë arsye, ai nuk është akt administrativ individual, edhe pse zbatimi i saj mund të prodhojë më pas akte individuale ndaj subjekteve konkrete.

Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019, është akt administrativ individual, në kuptim të nenit 2, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Ai i drejtohet konkretisht shoqërisë "A" sh.a. dhe e ngarkon atë me detyrimin në shumën 2,641,171 lekë. Ndryshe nga VKB-ja, ky akt nuk

vendos rregulla të përgjithshme, por konkretizon pasojën juridike ndaj një subjekti të individualizuar, duke krijuar një detyrim të përcaktuar monetar. Prandaj, ai është akt administrativ individual me natyrë tatimore, i nxjerrë në bazë dhe në zbatim të aktit nënligjor normativ.

Pyetje nr. 2 = 10 pikë

Arsyetoni mbi kompetencën e gjykatës administrative të shkallës së parë për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018 dhe të Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019.

Pikëzimi orientues:

Elementi i vlerësimit	Pikët
Referimi i saktë të neni 7 dhe neni 10 i ligjit nr. 49/2012 për kompetencën e gjykatës administrative të shkallës së parë.	2 pikë
Përfundimi se gjykata e shkallës së parë është kompetente për shqyrtimin e njoftim-vlerësimit si akt individual.	3 pikë
Përfundimi se kontrolli i drejtpërdrejtë i aktit nënligjor normativ i takon Gjykatës Administrative të Apelit.	3 pikë
Dallimi ndërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë dhe kontrollit incidental sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012.	2 pikë

Përgjigje:

Sipas nenit 7, shkronja “a”, dhe nenit 10 të ligjit nr. 49/2012, gjykatat administrative të shkallës së parë shqyrtojnë mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet administrative kolektive dhe kontratat administrative, me përjashtimet e parashikuara shprehimisht nga ligji. Duke qenë se Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019, është akt administrativ individual, kompetencën për shqyrtimin e kërimit për shfuqizimin e tij e ka gjykata administrative e shkallës së parë.

Ndryshe paraqitet situata për kërkimin që lidhet drejtpërdrejt me vendimin e Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018. Ky vendim ka natyrën e aktit nënligjor normativ. Neni 10 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative. Për rrjedhojë, shfuqizimi i drejtpërdrejtë i VKB-së nuk është në kompetencën funksionale të gjykatës administrative të shkallës së parë.

Megjithatë, ky përfundim nuk do të thotë se gjykata e shkallës së parë nuk mund të vlerësojë fare ligjshmërinë e VKB-së. Duhet dalluar shqyrtimi parësor i aktit normativ nga kontrolli incidental i tij. Gjatë gjykimit të aktit individual, gjykata administrative e shkallës së parë mund të verifikojë në mënyrë të tërthortë ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ mbi të cilin është mbështetur akti individual. Nëse e çmon të paligjshëm, gjykata nuk e shfuqizon VKB-në, por vendos të mos e zbatojë atë në rastin konkret dhe disponon vetëm mbi njoftim-vlerësimin tatimor.

Pyetje nr. 3 = 15 pikë

Referuar objektit të kërkesëpadisë, analizoni se çfarë vendimi do të marrë kjo gjykatë në lidhje me shqyrtimin ose jo të kësaj çështjeje.

Pikëzimi orientues:

Elementi i vlerësimit	Pikët
-----------------------	-------

Identifikimi se objekti i padisë përmban dy kërkime me natyrë të ndryshme: akt normativ dhe akt individual.	3 pikë
Përfundimi se gjykata e shkallës së parë është kompetente dhe vijon shqyrtimin për kërkimin ndaj njoftim-vlerësimit tatimor.	3 pikë
Përfundimi se gjykata e shkallës së parë nuk mund të shqyrtojë në themel dhe as të shfuqizojë drejtpërdrejt VKB-në si akt normativ.	3 pikë
Saktësimi se për kërkimin e pavarur për shfuqizimin e VKB-së, gjykata administrative e shkallës së parë duhet të deklarojë moskompetencën funksionale dhe t'ia dërgojë këtë kërkim Gjykatës Administrative të Apelit, pa cenuar vijimin e gjykimit për aktin individual.	3 pikë
Lidhja me gjykimin incidental: paligjshmëria e VKB-së trajtohet si shkak për shfuqizimin e aktit individual, jo si objekt i pavarur shfuqizimi nga gjykata e shkallës së parë.	3 pikë

Përgjigje:

Kompetenca lëndore dhe ajo funksionale përbëjnë një nga parakushtet procedurale, me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore ose funksionale për një forum gjyqësor bën që veprimtaria procedurale e kryer prej tij, në tejkallim të kompetencës, të jetë e cenueshme. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, së pari, duhet të veçojë kërkimet objekt padie, pasi ato u referohen dy akteve me natyrë të ndryshme juridike dhe, për rrjedhojë, ndjekin regjime të ndryshme kompetence.

Lidhur me kërkimin për shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019, gjykata duhet të vijojë gjykimin në shkallë të parë si gjykatë kompetente, sepse ky akt është akt administrativ individual, i cili i drejtohet konkretisht shoqërisë paditëse dhe prodhon pasoja të drejtpërdrejta ndaj saj.

Në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018, gjykata administrative e shkallës së parë nuk ka kompetencë funksionale për shqyrtimin e drejtpërdrejtë të këtij kërkimi, pasi ky vendim ka natyrën e aktit nënligjor normativ. Sipas nenit 10 të ligjit nr. 49/2012, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative shqyrtohen në shkallë të parë nga Gjykata Administrative e Apelit.

Për këtë arsye, gjykata administrative e shkallës së parë duhet të deklarojë moskompetencën funksionale vetëm për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e aktit nënligjor normativ dhe t'ia dërgojë aktet për këtë kërkim Gjykatës Administrative të Apelit. Ndërkohë, ajo duhet të mbajë për shqyrtim dhe të vijojë gjykimin për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e aktit administrativ individual, pra të njoftim-vlerësimit tatimor.

Në vijim të gjykimit për aktin individual, gjykata administrative e shkallës së parë mund të shqyrtojë vetëm në mënyrë incidentale ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak, në masën që ky akt normativ ka shërbyer si bazë për nxjerrjen e njoftim-vlerësimit tatimor. Në këtë rast, ajo nuk disponon për shfuqizimin e VKB-së, por, nëse e çmon të paligjshëm, mund të vendosë të mos e zbatojë atë në rastin konkret dhe të disponojë vetëm mbi aktin individual.

Pyetje nr. 4 = 7 pikë

A legjitimohet pala paditëse në rastin konkret për të kundërshtuar me padi drejtpërdrejt në gjykatë vendimin e Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë për vitin 2019”?

Pikëzimi orientues:

Elementi i vlerësimit	Pikët
Përgjigjja negative: pala paditëse nuk legjitimohet për kundërshtim të drejtpërdrejtë dhe abstrakt të VKB-së.	2 pikë
Shpjegimi i nenit 15, shkronja “d”, të ligjit nr. 49/2012: shoqatat dhe grupet e interesit.	2 pikë
Shpjegimi i përjashtimit kur akti normativ është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk ka mjet tjetër juridik.	2 pikë
Zbatimi mbi rastin konkret: ekziston njoftim-vlerësimi tatimor si akt individual zbatues.	1 pikë

Përgjigje:

Pala paditëse nuk legjitimohet të kundërshtojë drejtpërdrejt, në mënyrë abstrakte, vendimin e Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018, si akt nënligjor normativ. Ajo legjitimohet të kundërshtojë aktin administrativ individual që e ka ngarkuar me detyrimin tatimor, pra Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019.

Neni 15, shkronja “d”, i ligjit nr. 49/2012 parashikon një rregullim të posaçëm për legjitimimin aktiv në kundërshtimin e aktit nënligjor normativ. Si rregull, të drejtën për të kundërshtuar në mënyrë abstrakte aktin normativ e kanë shoqatat dhe grupet e interesit, kur pretendojnë cenimin e një interesi të ligjshëm publik brenda fushës së tyre të veprimtarisë. Në rastin konkret, Shoqëria “A” sh.a. është shoqëri tregtare dhe mbron një interes individual pasuror. Ajo nuk vepron si shoqatë apo grup interesi në mbrojtje të një interesi publik kolektiv.

Përjashtimisht, një subjekt privat mund të kundërshtojë drejtpërdrejt aktin nënligjor normativ vetëm kur provon se akti është drejtpërdrejt i zbatueshëm ndaj tij, i shkakton një dëm konkret, aktual dhe të sigurt, dhe se nuk ka asnjë mjet tjetër juridik për mbrojtjen e së drejtës apo interesit të ligjshëm. Në rastin konkret ky përjashtim nuk zbatohet, sepse ekziston një akt individual zbatues- njoftim-vlerësimi tatimor- i cili mund të kundërshtohet në gjykatën administrative të shkallës së parë. Për këtë arsye, pala paditëse nuk legjitimohet për goditjen e drejtpërdrejtë të VKB-së.

Pyetje nr. 5 = 10 pikë

Cili është instrumenti i duhur ligjor që mund të përdorë në këtë rast pala paditëse në gjykimin për kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë, datë 26.12.2018? Si do ta formuloni objektin e padisë?

Pikëzimi orientues:

Elementi i vlerësimit	Pikët
Identifikimi i gjykimit incidental si instrumenti i duhur ligjor, sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012.	3 pikë

Shpjegimi se gjykata kontrollon në mënyrë të tërthortë ligjshmërinë e VKB-së, por nuk e shfuqizon atë.	2 pikë
Shpjegimi i pasojës: mënjanimi i zbatimit të aktit normativ vetëm në rastin konkret dhe disponimi mbi aktin individual.	2 pikë
Formulimi i saktë i objektit të padisë dhe roli i shkaqeve të paligjshmërisë së VKB-së në përmbajtjen e padisë.	3 pikë

Përgjigje:

Instrumenti i duhur ligjor është gjykimi incidental, i parashikuar në nenin 38 të ligjit nr. 49/2012. Sipas kësaj dispozite, gjykata administrative, gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë të mos zbatojë një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm. Ky kontroll mund të bëhet edhe kur shqyrtimi parësor i aktit normativ nuk është në kompetencën funksionale të gjykatës që po gjykon aktin individual.

Në këtë mënyrë, pala paditëse nuk duhet ta formulojë padinë si kërkim të pavarur për shfuqizimin e drejtpërdrejtë të vendimit të Këshillit Bashkiak. Ajo duhet të kundërshtojë aktin individual që ka prodhuar pasojën konkrete ndaj saj dhe, në përmbajtje të padisë, të parashtrojë se ky akt individual është i paligjshëm sepse është mbështetur në një akt nënligjor normativ të paligjshëm. Gjykata, nëse pranon këtë pretendim, nuk e shfuqizon VKB-në në dispozitiv, por mënjanon zbatimin e saj për rastin konkret dhe disponon për shfuqizimin e njoftim-vlerësimit tatimor:

Objekti i padisë mund të formulohet kështu:

“Shfuqizimin e Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 88 prot., datë 30.07.2019, me të cilin shoqëria ‘A’ sh.a. është ngarkuar me detyrimin në masën 2,641,171 lekë.”

Në pjesën arsyetuese të kërkesëpadisë, pala paditëse duhet të parashtrojë se ky akt individual është i paligjshëm, pasi është nxjerrë në bazë dhe në zbatim të pikës 2/II të VKB-së, të cilën gjykata kërkohet ta kontrollojë incidentalisht sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012.

Elvana Gicollari

